



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Mbrojtje e Bimëve

Programi: Mbrojtje e Bimëve- Fitomedicinë

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidatja Anita Avdullahu, me titull: **“PËRHAPJA E *SITOPHILUS GRANARIUS* NË DISA MULLINJ TË GRURIT NË KOMUNËN E DRENAS-IT DHE MASAT PËR MENAXHIMIN E DËMTUESIT”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 12/07/2024 deri me datë 18/07/2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Salih Salihu, kryetar,
2. Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa, mentor - anëtar,
3. Prof. Asoc. Dr. Imer Haziri, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa, përmes e-mail adresës fadil.musa@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI I MBROJTJES SË BIMËVE

Mbrojtja e bimëve - Fitomedicinë



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Përhapja e *Sitophilus granarius* në disa mullinj të grurit në komunën e Drenas-it dhe masat për menaxhimin e dëmtuesit

Udhëheqësi:

Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa

Kandidatja:

Anita Avdullahu Dvorani

Prishtinë, Korrik 2024

ABSTRAKTI

Gruri (*Triticum aestivum*) është një nga kulturat lavërtare më të njohura dhe më të përhapura në të gjithë botën. Sipërfaqet me grurë në vendin tonë sillen mesatarisht prej 70000-80 000 ha me oscilime të vogla nga viti në vit.

Në prodhimtarinë e grurit në fushë të hapur, atë e prek një numër i konsiderueshëm i dëmtuesve të ndryshëm duke i shkaktuar dëme të konsiderueshme kësaj kulture, sikurse në rendiment ashtu edhe në cilësinë e saj. Kokrrën e grurit e prekin edhe një numër i konsiderueshëm i dëmtuesve gjatë ruajtjes dhe deponimit nëpër vende të ndryshëm, mullinj, depo, silose, etj. Pa dyshim se nga këta dëmtues si më i rrezikshëm paraqitet edhe turigjati i grurit (*Sitophilus granarius*) i cili për çdo vit paraqitet në vendin tonë. Qëllimi i këtij punimi ka qenë të hulumtohet shfaja dhe përhapja e këtij dëmtuesi në grurin e deponuar në dy mullinj të ndryshëm në komunën e Drenasit (Tërstenik dhe Komoran).

Eksperimenti është realizuar sipas metodës së blloqeve të randomizuara në tri përsëritje. Në secilën përsëritje sipas metodës së rastit janë marrë mostrat e grurit nga mullinj të përfshirë në hulumtime në intervale dhjetë ditore, në gjithësejtë gjashtë termine të mostrimit.

Mostrat e grurit të cilat janë marrë në vende të ndryshme tek mullinjët e hulumtuar janë sjellë dhe janë testuar në laboratorin e mbrojtjes së bimëve në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë për identifikimin e tyre. Për identifikimin e dëmtuesve të ndryshëm por edhe të turigjatit të grurit janë përdorur çelësa dhe atlase të ndryshme adekuate entomologjike. Rezultatet e fituara më pas janë përpunuar në mënyrë statistikore duke shfrytëzuar programin kompjuterik MSTAT-C dhe paketën Microsoft Office.

Sa i përket prekjës së grurit në dy mullinjë e hulumtuar nga turigjati i grurit si total si më i prekur është konstatuar të jetë mulliri në Tërstenik ku numri i individëve të konstatuar të këtij dëmtuesi, ka qenë 548, ndërsa më së paku ka qenë i prekur mulliri në Komoran ku numri i dëmtuesit ka qenë 469 individë.

Sa i përket fazave të ndryshme të zhvillimit të këtij dëmtuesi gjatë këtyre hulumtimeve janë konstatuar 4 prej tyre, pra të gjitha fazat e mundshme (veza, larva, nimfa dhe imago).

Përmes analizës së variansës dhe testimit me LSD, nuk janë konstatuar dallime statistikore në mes të mullinjëve të grurit të përfshirë në eksperiment, sa i përket prekjës nga turigjati i grurit.

Numri më i madh i dëmtuesit duke mos përjashtuar asnjërën fazë të zhvillimit si mesatare gjatë vegjetacionit është konstatuar te mulliri në Tërstenik (22.83) kurse më i vogël te mulliri në Komoran (19.54).

Dinamika e popullacionit të turigjatit të grurit gjatë këtyre hulumtimeve ka qenë e ndryshme te mullinjtë e ndryshëm të grurit. Kështu te të gjithë mullinjtë e testuar të grurit ky dëmtues është konstatuar pothuajse në fillim të hulumtimeve dhe me kalimin e kohës ka rritur nivelin e popullacioneve të tyre.

Nga shkalla e prekjës së grurit në mullinjtë e hulumtuar nga turigjati i grurit gjithsesi se rekomandojmë masat e menaxhimit të këtij dëmtuesi por edhe të dëmtuesve të tjerë që eventualisht mund të shfaqen.

Në kuadër të Mbrojtjes së integruar duhet ndërmarrë masat mbrojtëse ku përparësi duhet dhënë masave të tjera sikurse janë: masat parandaluese, higjienike dhe masat të tjera agroteknike të rregullta, dhe si alternativë e fundit edhe përdorimin e preparateve kimike.

Të dhënat e fituara kanë rëndësi të madhe praktike dhe teorike sepse për herë të parë në detaje është hulumtuar dëmtuesi *Sitophilus granarius* i cili me të madhe kërcënon grurin e deponuar në ambiente të ndryshme (depo, mullinj, silose, hambarë, etj). Të dhënat e fituara mund të përdoren edhe nga subjektet të cilat merren grumbullimin, deponimin, tregtimin dhe përpunimin e grurit në funksion të menaxhimit të Integruar të këtij dëmtuesi mjaft të rrezikshëm.